



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 225

Tiranë – E premte, 22 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 98/2017 datë 2.11.2017	Për tarifatat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë..... 11967
Vendim i Kuvendit nr. 114/2017, datë 18.12.2017	Për rrëzimin e dekretit nr. 10 656, datë 22.11.2017, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 98/2017, “Për tarifatat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”” 11969
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 737, datë 13.12.2017	Për ngritjen e qendrës së koordinimit kundër ekstremizmit të dhunshëm (QKEDH) 11970
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 738, datë 13.12.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 519, datë 20.9.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të territorit” 11971
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 739, datë 13.12.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 725, datë 2.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit” 11971
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 742, datë 13.12.2017	Për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941, dhe për ndërtimin e vendpreshjes për ta, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr. 10256, datë 25.3.2010..... 11972
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 743, datë 13.12.2017	Për një shtesë fondi dhe një ndryshim në vendimin nr. 22, datë 18.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Punëve të Brendshme, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore për viktimat e ngjarjes së 21 janarit 2011” 11973

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 744, datë 13.12.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 892, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimin për gradat në Policinë e Shtetit”	11975
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 747, datë 13.12.2017	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Brendshme, për shpërblimin e disa punonjësve të strukturave në Forcat e Armatosura dhe Policinë e Shtetit, të angazhuar në situatën emergjente të krijuar në disa zona të vendit nga përmbytjet.....	11975
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 752, datë 13.12.2017	Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil.....	11976
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 753, datë 13.12.2017	Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2017- 2018.....	11976
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 754, datë 13.12.2017	Për disa ndryshime në vendimin nr. 408, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për dëmshpërblimin për kafshët e eliminuara”, të ndryshuar.....	11981
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 755, datë 13.12.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 712, datë 13.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë”	11981



LIGJ
Nr. 98/2017

PËR TARI FAT GJYQËSORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

1. Ky ligj ka për objekt përcaktimin e llojeve të tarifave gjyqësore, masën, mënyrën dhe afatin e pagesës dhe rastet e përjashtimit nga pagimi i tyre.

2. Tarifat gjyqësore, sipas këtij ligji, janë:

a) tarifa gjyqësore të përgjithshme, për paraqitjen e çështjeve në gjykata;

b) tarifa gjyqësore të veçanta, për kryerjen e veprimeve procedurale në gjykata dhe shërbimet e administratës gjyqësore; dhe

c) tarifa gjyqësore shtesë, në funksion të administrimit korrekt të procesit gjyqësor.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i tarifave gjyqësore në gjykimin e çështjeve civile, administrative dhe në gjykimin në Gjykatën Kushtetuese, me qëllim përfitimin e shërbimeve efektive dhe cilësore të ofruara nga gjykata.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Tarifë gjyqësore” është një pagesë që palët në proces kryejnë nëpërmjet administratës gjyqësore në favor të administratës tatimore qendrore.

2. “Palë në proces” është personi fizik ose juridik ose përfaqësuesi i tij ligjor që ka vënë në lëvizje gjykatën, me qëllim zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje në rrugë gjyqësore.

3. “Gjykata”, sipas kuptimit të dhënë nga ky ligj, janë gjykatat e sistemit gjyqësor dhe Gjykata Kushtetuese.

Neni 4
Fusha e zbatimit

1. Tarifat gjyqësore të përcaktuara në këtë ligj zbatohen për të gjitha çështjet gjyqësore civile dhe administrative të paraqitura për shqyrtim në gjykatë dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

2. Tarifat gjyqësore zbatohen edhe për përfitimin e shërbimeve të ofruara nga gjykata.

Neni 5
Përcaktimi i tarifës gjyqësore
të përgjithshme

1. Tarifa gjyqësore e përgjithshme për paraqitjen e kërkesëpadisë për llogaritë mbi bazën e vlerës së padisë për çështje gjyqësore civile dhe administrative.

2. Masa e tarifave gjyqësore të përgjithshme, sipas pikës, 1 të këtij neni, është jo më e ulët se 1 000 (një mijë) lekë dhe jo më e lartë se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

3. Masa e tarifave gjyqësore të përgjithshme për gjykimet në gjykatat e apelit dhe Gjykatën e Lartë është jo më e ulët se 2 000 (dy mijë) lekë dhe jo më e lartë se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

4. Tarifa gjyqësore e përgjithshme për paraqitjen e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese është 5 000 (pesë mijë) lekë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 9 të këtij ligji.

5. Përcaktimi i vlerës së padisë bëhet nga personi, i cili ka ngritur padinë përpara gjykatës.

6. Në rast se për llogaritja e vlerës së padisë mungon ose nuk është llogaritur në mënyrë të saktë, vepohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

7. Kur çështja gjyqësore kthehet për rigjykim nga gjykatat më të larta, nuk paguhet tarifë gjyqësore e përgjithshme.

8. Llojet dhe masat përkatëse të tarifave gjyqësore të përgjithshme, sipas këtij neni, për çdo shkallë gjykimi, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për drejtësinë dhe ministrit përgjegjës për financat, me propozimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbi bazën e natyrës së çështjes, parimeve të proporcionalitetit dhe progresivitetit.



Neni 6

Momenti i pagimit të tarifës gjyqësore të përgjithshme

1. Tarifa gjyqësore e përgjithshme paguhet në momentin e paraqitjes së padisë, të ankimit, të ankimit të veçantë ose të rekursit në gjykatë, përveçse kur ligji parashikon ndryshe.

2. Tarifa gjyqësore e përgjithshme për paraqitjen e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese paguhet në momentin e paraqitjes së kërkesës pranë kësaj gjykate.

3. Nëse tarifa gjyqësore e përgjithshme nuk është paguar në momentin e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, gjykata vepron në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

4. Tarifa gjyqësore e përgjithshme paguhet gjatë gjykimit ose përpara dhënies së vendimit përfundimtar vetëm në rastet e mëposhtme:

a) kur çështja gjyqësore ka për objekt dhënien e pensionit ushqimor;

b) për paditë për marrëdhëniet e punës në vlerë deri në 700 000 (shtatëqind mijë) lekë.

5. Tarifa e paguar nuk kthehet kur hiqet dorë nga kryerja e veprimeve gjyqësore.

Neni 7

Tarifa gjyqësore shtesë

1. Tarifa gjyqësore shtesë caktohet në rastet kur pala ndërgjyqëse ose përfaqësuesi i saj ka shkaktuar pa shkaqe të arsyeshme vonesa në gjykim e çështjes.

2. Tarifa gjyqësore shtesë paguhet brenda 21 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të vendimit të gjykatës.

3. Tarifa gjyqësore shtesë është tarifë fikse dhe përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për drejtësinë dhe ministrit përgjegjës për financat, me propozimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në proporcion me tarifën gjyqësore të përgjithshme, sipas nenit 5 të këtij ligji.

Neni 8

Tarifa gjyqësore e veçantë

1. Tarifa gjyqësore e veçantë caktohet për shqyrtimin e kërkesave të veçanta procedurale gjatë zhvillimit të gjykimit në të gjitha shkallët e gjykimit dhe në të gjitha juridiksionet gjyqësore, si dhe për shërbime të administratës gjyqësore.

2. Tarifa gjyqësore e veçantë paguhet në kohën e paraqitjes së kërkesës në gjykatë.

3. Tarifat gjyqësore të veçanta janë jo më e ulëta se 50 (pesëdhjetë) lekë dhe jo më të larta se 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë. Masa për llojet e tarifave gjyqësore të veçanta përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për drejtësinë dhe ministrit përgjegjës për financat, me propozimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas parimeve të proporcionalitetit dhe progresivitetit.

Neni 9

Përfundime nga pagesa e tarifës gjyqësore

1. Palët ndërgjyqëse mund të përjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifë gjyqësore ose shpenzimet e tjera gjyqësore kur është bërë kërkesë prej tyre, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike.

2. Çdo organ publik buxhetor që kryen funksione administrative, gjykatat ose prokuroria, përjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifë gjyqësore, përveç rasteve kur humbasin çështjen gjyqësore dhe ligji procedural parashikon detyrimin e tyre për paguar shpenzimet e palës tjetër.

3. Rregulli i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, nuk zbatohet për Avokaturën e Shtetit, e cila përjashtohet edhe nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore.

Neni 10

Mënyra e pagimit të tarifës gjyqësore

1. Tarifa gjyqësore mbledhet dhe paguhet sipas mënyrës së përcaktuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për drejtësinë dhe ministrit përgjegjës për financat, pas marrjes së mendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Nga shuma e përgjithshme e arkëtuar për tarifën gjyqësore 10 për qind i kalon buxhetit gjyqësor.

3. Mbi tarifën gjyqësore të parashikuar në këtë ligj nuk aplikohet tatimi mbi vlerën e shtuar.

Neni 11

Deklarimi i tarifave

1. Administratat gjyqësore, në cilësinë e agjentëve të mbledhjes së tarifave të parashikuar në këtë ligj, detyrohen:

a) të bëjnë një deklaratë për çdo muaj për të ardhurat e mbledhura nga tarifa, jo më vonë se 15



ditë pas përfundimit të muajit për të cilin bëhen deklarimet;

b) të paguajnë për llogari të drejtorisë rajonale tatimore tarifën e arkëtuar për atë muaj në datën ose para datës së detyrueshme të deklaratës.

2. Deklarata, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, bëhet në formën dhe përmbajtjen që përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave. Deklarata për pagesën e tarifës gjyqësore plotësohet dhe dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike nga administrata e gjyqësore. Deklarata konsiderohet e dorëzuar, në datën e dërgimit elektronik të deklaratës së plotësuar. Administratat gjyqësore duhet të dorëzojnë deklaratën edhe në qoftë se për periudhën tatimore nuk kanë për të paguar detyrime për tarifën.

3. Në rast shkeljeje të parashikimeve të këtij neni, ndaj administratës gjyqësore zbatohen sanksionet e parashikuara nga neni 117 i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 12

Auditimi i tarifave gjyqësore

1. Përlllogaritja dhe arkëtimi i tarifave gjyqësore verifikohet dhe vlerësohet sipas legjislacionit në fuqi për auditimin e brendshëm dhe të jashtëm në sektorin publik.

2. Kur vlera dhe procedura e caktimit të tarifës është ankimuar në gjykatat më të larta, vendimi gjyqësor përkatës mbahet në konsideratë në procedurën e auditimit të brendshëm apo të jashtëm.

Neni 13

Dispozitë kalimtare

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha çështjet gjyqësore që paraqiten në gjykata pas hyrjes në fuqi të tij.

2. Deri në miratimin e akteve nënligjore të parashikuara nga ky ligj, tarifën gjyqësore do të përlllogariten dhe zbatohen në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për taksat kombëtare dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Neni 14

Akte nënligjore

Ngarkohet ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave që, brenda 3 muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, të miratojnë

aktet nënligjore të parashikuara në pikën 8, të nenit 5, në pikën 3, të nenit 7, në pikën 3, të nenit 8, dhe në pikën 1, të nenit 10, të këtij ligji.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në datën 1 qershor 2018.

Përjashtëmishit neni 14 i këtij ligji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 2.11.2017

VENDIM Nr. 114/2017

PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 10 656, DATË 22.11.2017, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 98/2017, “PËR TARIFAT GJYQËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË””

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 10 656, datë 22.11.2016, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 98/2017, “Për tarifën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë””.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 18.12.2017



VENDIM
Nr. 737, datë 13.12.2017

**PËR NGRITJEN E QENDRËS
SË KOORDINIMIT KUNDËR
EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM
(QKEDH)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin të Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (në vijim QKEDH), si person juridik publik, buxhetor, në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë.

2. QKEDH-ja ka stemën, logon dhe vulën zyrtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Misioni i qendrës është zhvillimi i kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm të përfshirë në veprimet kundër ekstremizmit të dhunshëm, ruajtja dhe promovimi i vlerave të tolerancës dhe të harmonisë fetare, mbrojtja e të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës dhe demokracisë, si dhe mbrojtja e shoqërisë shqiptare nga ekstremizmi i dhunshëm.

4. Për qëllime të këtij vendimi do të gjejnë zbatim përkufizimet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe planin e veprimit të saj, miratuar me vendimin nr. 930, datë 18.11.2015, të Këshillit të Ministrave.

5. QKEDH-ja ngarkohet me ushtrimin e kompetencave, si më poshtë vijon:

a) Bashkërendon, harton dhe monitoron projekte, aktivitete, politika, procedura për parandalimin, kundërradikalizmin dhe riintegrimin e shtetasve shqiptarë;

b) Koordinon në nivel kombëtar dhe lokal ndërhyrje në komunitetet në nevojë për rastet e radikalizmit dhe të ekstremizmit të dhunshëm;

c) Realizon dhe mbikëqyr projekte, aktivitete të iniciuara nga vetë qendra apo në bashkëpunim me institucionet e tjera qendrore dhe/ose lokale, apo të iniciuara nga palët e treta/shoqëria civile;

ç) Harton procedura për parimet, terminologjinë dhe përkufizimet për trajnimet e punonjësve të linjës së parë, por jo vetëm;

d) Kryen rishikimin e projekteve të secilit institucion, të parashikuara në Strategjinë Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe planit të veprimit të saj, kërkon raporte nga këto institucione dhe bashkëpunon për përbushjen e përgjegjësive;

dh) Informon, të paktën një herë në gjashtë muaj, Kryeministrin, për çështjet e mësipërme.

6. Veprimtaria ekzekutive e QKEDH-së realizohet nga drejtori, i cili emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Kryeministri.

7. Drejtori i QKEDH-së ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesore:

a) Përfaqëson qendrën në marrëdhënie me të tretët dhe drejton veprimtarinë e saj;

b) I propozon Kryeministrit rregulloren e brendshme të QKEDH-së;

c) Kontrollon dhe garanton përbushjen e misionit dhe të objektivave të QKEDH-së, si dhe të detyrimeve që ka ky institucion;

ç) Është përgjegjës për administrimin teknik, organizativ, financiar e të burimeve njerëzore të QKEDH-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) Autorizon personat që mund të përfaqësojnë QKEDH-në në mungesë të tij;

dh) Drejton dhe kontrollon veprimtarinë e QKEDH-së, duke nxjerrë urdhra, udhëzime dhe porosi, me shkrim ose verbale, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga punonjësit e qendrës;

e) Nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me zyra homologe të vendeve të tjera ose me institucione shqiptare, kur këto janë të nevojshme, për përbushjen e detyrimeve ligjore që ka QKEDH-ja, në fushën e radikalizmit dhe të ekstremizmit të dhunshëm;

ë) Emëron punonjësit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

f) Vendos për të gjitha çështjet e veprimtarisë së QKEDH-së, brenda kufijve të planit financiar dhe të dispozitave ligjore në fuqi;

g) Përgjigjet për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion, në përputhje me legjislacionin në fuqi;



gj) Përgjigjet për të gjitha çështjet e administrimit të QKEDH-së dhe raporton pranë Kryeministrit.

Detyrat dhe kompetencat e detajuara të drejtorit përcaktohen në rregulloren e brendshme të qendrës.

8. Organizimi i brendshëm (struktura dhe organika) i QKEDH-së miratohet me urdhër të Kryeministrit.

9. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e QKEDH-së funksionojnë mbi bazën e kontratave të punës me kohë të plotë dhe të pjesshme, në përputhje me rregullat e parashikuara në dispozitat përkatëse të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë. Mënyra e testimit, e rekrutimit të punonjësve, si dhe rregullat e disiplinës përcaktohen në rregulloren e brendshme.

10. Për realizimin e detyrave QKEDH-ja ka buxhetin e saj, që krijohet nga:

- a) buxheti i shtetit;
- b) të ardhurat nga donatorët vendës a të huaj;
- c) të ardhura të tjera të ligjshme.

11. Të gjitha donacionet ose të ardhurat e tjera të ligjshme që i vijnë qendrës, përdoren sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

12. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të QKEDH-së, miratohet nga Kryeministri, me propozimin e drejtorit të qendrës.

13. Ngarkohet Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2018.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 738, datë 13.12.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 519, DATË 20.9.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 6, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 5, e vendimit nr. 519, datë 20.9.2017, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga dita e zhvillimit të mbledhjes, Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT) zbardh vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit, të cilat ua dërgon për nënshkrim Kryeministrit, në cilësinë e kryetarit të KKT-së, dhe ministrit të linjës për zhvillimin e propozuar.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 739, datë 13.12.2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 725, DATË 2.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT”

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 725, datë 2.9.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:



1. Në pikën 1, të kreut I, “Dispozita të përgjithshme”, fjalët “...ministrit përgjegjës për zhvillimin urban, në vijim ministri...”, zëvendësohen me emërtimin “Kryeministrit”.

2. Në pikën 2, të kreut I, “Dispozita të përgjithshme”, në fjalinë e parë, fjala “Ministri”, zëvendësohet me emërtimin “Kryeministri”. Ndërsa, në fjalinë e dytë, emërtimi “Ministria e Zhvillimit Urban” zëvendësohet me “Kryeministria”.

3. Në pikën 1, të kreut II, “Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë”, fjala “Ministri” zëvendësohet me emërtimin “Kryeministrit”.

4. Pika 2, e kreut II, “Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë”, ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“2. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra me urdhër të Kryeministrit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm, i cili është, njëkohësisht, drejtor i një drejtorie, emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Drejtori i Përgjithshëm.”.

5. Në pikën 3, të kreut II, “Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë”, fjala “Ministri”, zëvendësohet me emërtimin “Kryeministrit”.

6. Në shkronjën “dh”, të pikës 1, të kreut III, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Agjencisë”, fjalët “...regjistrin e integruar të territorit...”, zëvendësohen me “...sistemin elektronik të lejeve...”.

7. Në shkronjën “ë”, të pikës 1, të kreut III, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Agjencisë”, fjalët “...regjistrin të integruar të territorit...”, zëvendësohen me “...sistemit elektronik të lejeve...”.

8. Në fund të shkronjës “f”, të pikës 1, të kreut III, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Agjencisë”, shtohen fjalët “...dhe zhvillimin e territorit...”.

9. Në pikën 1, të kreut III, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Agjencisë”, pas shkronjës “f”, shtohet shkronja “g”, me përmbajtje, si më poshtë vijon:

“g) përfaqësuar Këshillin Kombëtar të Territorit, në të gjitha çështjet objekt shqyrtimi gjyqësor, që kanë lidhje me vendimet e miratuara dhe procedurat e kryera nga Këshilli Kombëtar i Territorit.”.

II. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 742, datë 13.12.2017

**PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES
SË BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
SË GREQISË, PËR KËRKIMIN,
ZHVARRIMIN, IDENTIFIKIMIN DHE
VARRIMIN E USHTARAKËVE GREKË,
TË RËNË NË SHQIPËRI GJATË LUFTËS
GREKO-ITALIANE TË VITEVE 1940-1941,
DHE PËR NDËRTIMIN E
VENDPREHJES PËR TA, BRENDA
TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, RATIFIKUAR ME LIGJIN
NR. 10256, DATË 25.3.2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 5, të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941, dhe për ndërtimin e vendprehjes për ta, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr. 10256, datë 25.3.2010, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të ndjekin procesin e shpronësimit të trojeve për ndërtimin e vendprehjeve të ushtarakëve grekë, të rënë gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941, të përcaktuar sipas marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri



gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941, dhe për ndërtimin e vendpërshes për ta brenda territorit të Republikës Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr. 10256, datë 25.3.2010, në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar.

2. Ministria e Mbrojtjes, në bashkërendim me Ministrinë e Brendshme, të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për marrjen në administrim të trojeve për ndërtimin e vendpërshesjeve, sipas ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”.

3. Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me bashkitë të cilat do të jenë pjesë e procesit të kërkimit, identifikimit, zhvarrimit dhe varrimit të eshtrave, të sigurojë të gjitha lejet për procesin, të përgatitë të gjithë dokumentacionin shoqërues, si dhe të marrë të gjitha masat për të bërë të mundur fillimin dhe vazhdimin e procesit në zbatim të marrëveshjes.

4. Prefekti i qarkut ku do të zhvillohen punimet e kërkimit, identifikimit, zhvarrimit dhe varrimit të eshtrave, në bashkëpunim me bashkitë përkatëse, të ofrojë të gjithë infrastrukturën e nevojshme për zbatimin e procesit të kërkimit, identifikimit, zhvarrim-varrimit në territoret e tyre.

5. Me urdhër të Kryeministrit, në zbatim të neneve 2, pika 5, dhe 4, shkronja “a”, të marrëveshjes, të përcaktohen ekspertët e palës shqiptare në Komitetin e Përbashkët të Ekspertëve Shqiptarë dhe Grekë për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e eshtrave, si dhe ekspertët në terren të palës shqiptare.

6. Ministrinë dhe institucionet e tjera shtetërore, të përfaqësuara me ekspertë në Komitetin e Përbashkët në terren të përballojnë shpenzimet për realizimin e detyrave nga këta ekspertë, sipas legjislativës në fuqi.

7. Ministria e Mbrojtjes, në zbatim të pikës 8, të nenit 1, të marrëveshjes, të organizojë, në bashkëpunim me palën greke, ceremonitë zyrtare në përkujtim të të rënëve në luftë, çdo vit, në datën 28 tetor.

8. Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrë masat e nevojshme për zbatimin e të gjitha procedurave të zhdoganimit dhe të përjashtimit nga detyrimet doganore sipas ligjit nr. 10256, datë 25.3.2010.

9. Vendimi nr. 496, datë 29.6.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941, dhe për ndërtimin e vendpërshes për ta, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr. 10256, datë 25.3.2010”, shfuqizohet.

10. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe prefektët e qarqeve ku do të zhvillohen punimet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 743, datë 13.12.2017

**PËR NJË SHITESË FONDI DHE NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 22,
DATË 18.1.2017, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR NJË SHITESË FONDI
NË BUXHETIN E VITIT 2017, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E PUNËVE
TË BRENDSHME, NGA FONDI
REZERVË I BUXHETIT TË SHTETIT,
PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE
QË RRJEDHIN NGA ZBATIMI
I VENDIMEVE GJYQËSORE
PËR VIKTIMAT E NGJARJES
SË 21 JANARIT 2011”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2017, t'i shtohet fondi prej 129 672 594 (njëqind e njëzet e nëntë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e



nëntëdhjetë e katër) lekësh, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore për viktimat e ngjarjes së 21 janarit 2011, sipas lidhjes nr.1/1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Lidhja nr. 1, bashkëlidhur vendimit nr. 22, datë 18.1.2017, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen nr. 1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja Nr. 1/1

Rasti	Gjykata	Vlera e detyrimit
Vendimi nr. 3968, datë 28.7.2016	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë.	42 021 626 lekë
Vendimi nr.6148, datë 21.12.2016	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë.	23 619 896 lekë
Vendimi nr. 6292, datë 28.12.2016	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë.	18 836 416 lekë
Vendimi nr. 6242 datë 27.12.2016	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, i formës së prerë	75 533 541 lekë
Totali i detyrimeve, i shlyer me fondin e çelur sipas VKM-së nr. 22 datë 18.1.2017		Vlera 160 011 479 lekë
Vendimi nr. 944, datë 10.3.2017	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë.	23 334 741 lekë
Vendimi nr. 382, datë 9.2.2017	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë.	32 223 356 lekë
Vendimi nr. 179, datë 30.1.2017	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë.	73 853 897 lekë
Shpenzime të tjera gjyqësore, sipas vendimit nr. 24, datë 7.3.2017, "Për ndreqje gabimi në vendimin nr. 6242, datë 7.3.2017	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë,	97 300 lekë
Shpenzime të tjera gjyqësore, sipas vendimit nr. 16, datë 8.2.2017, "Për ndreqje gabimi në vendimin nr. 6292m, datë 28.12.2016	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë,	163 300 lekë
Totali i detyrimeve të fondit shtesë, sipas pikës 1, të këtij vendimi		Vlera 129 672 594 lekë



VENDIM

Nr. 744, datë 13.12.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 892, DATË 21.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE KORRESPONDUESE DHE KATEGORIZIMIN PËR GRADAT NË POLICINË E SHTETIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 61, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të vendimit nr. 892, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, fjalët “... deri në 1 vit...”, ndryshohen dhe bëhen “... deri në 2 vjet...”.

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 747, datë 13.12.2017

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2017, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES DHE MINISTRINË E BRENDSHME, PËR SHPËRBLIMIN E DISA PUNONJËSVE TË STRUKTURAVE NË FORCAT E ARMATOSURA DHE POLICINË E SHTETIT, TË ANGAZHUAR NË SITUATËN EMERGJENTE TË KRIJUAR NË DISA ZONA TË VENDIT NGA PËRMBYTJET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.1998, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001, “Për emergjencat civile”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2017 të bëhet një shtesë fondi prej 63 290 000 (gjashtëdhjetë e tre milionë e dyqind e nëntëdhjetë mijë) lekësh për shpërblimin e punonjësve të disa strukturave në Forcat e Armatosura dhe Policinë e Shtetit, të angazhuar gjatë situatës emergjente të krijuar në disa zona të vendit si rezultat i përmbytjeve natyrore, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Mbrojtjes, në programin buxhetor “Forcat e luftimit”, t’i shtohet fondi prej 56 690 000 (pesëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë) lekësh, për shpërblimin e disa punonjësve të strukturave në Forcat e Armatosura;

b) Ministrisë së Brendshme, në programin buxhetor “Policia e Shtetit”, t’i shtohet fondi prej 6 600 000 (gjashtë milionë e gjashtëqind mijë) lekësh, për shpërblimin e disa punonjësve të Policisë së Shtetit.

2. Personeli i angazhuar në Ministrinë e Mbrojtjes të shpërblehet, si më poshtë vijon:

- 298 punonjës nga Forcat e Armatosura, në shumën 14 900 000 (katërbëdhjetë milionë e nëntëqind mijë) lekësh;

- 1 560 punonjës nga Forcat e Armatosura, në shumën 31 200 000 (tridhjetë e një milionë e dyqind mijë) lekësh;

- 1 059 punonjës nga Forcat e Armatosura, në shumën 10 590 000 (dhjetë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë mijë) lekësh.

3. Shpërblimi i punonjësve të angazhuar në strukturat e Policisë së Shtetit të bëhet, në masën 20 000 lekë/punonjës, për 330 punonjës dhe konkretisht:

- Për repartin special “Renea” dhe repartet e FNSH-ve Tiranë, Fier dhe Shkodër, 70 punonjës;

- Për Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, 60 punonjës;

- Për Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, 30 punonjës;

- Për Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, 30 punonjës;

- Për Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, 70 punonjës;

- Për Drejtorinë Vendore të Kufirit, Migracionit Vlorë dhe repartin “Delta Force”, 70 punonjës.

4. Listat përkatëse me emrat e punonjësve të strukturave të Forcave të Armatosura e të Policisë



së Shtetit dhe masën e shpërblimit të miratohen përkatësisht nga ministri i Mbrojtjes e ministri i Brendshëm.

5. Shtesa e fondit, prej 63 290 000 (gjashtëdhjetë e tre milionë e dyqind e nëntëdhjetë mijë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

6. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Brendshëm dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 752, datë 13.12.2017

PËR EMËRIMIN E KRYETARIT DHE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr. 10233, datë 11.2.2010, “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërimin në detyrën e kryetarit dhe të anëtarëve të këshillit drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil, si më poshtë vijon:

- Z. Sandër Lleshi, kryetar;
- Znj. Brunilda Lilo, anëtar;
- Z. Hajrulla Çeku, anëtar;
- Z. Vladimir Avdiqaj, anëtar;
- Znj. Etleva Kondi, anëtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 753, datë 13.12.2017

PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE, PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE DHE PAGESAVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2017 - 2018

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 19 dhe 28, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr.15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 1 e 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të nenit 6, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të nenit 32, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nxënësit që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.



2. Nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kritereve, si më poshtë vijon:

2.1 Sipas kriterit ekonomik:

a) Nxënësit e arsimit parauniversitar që vazhdojnë studimet në largësinë mbi 5 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre e që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Nxënësit e arsimit parauniversitar që banojnë në zonat rurale, që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km, që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe akomodohen në konvikte publike.

2.2 Sipas rezultateve të arritura:

Nxënësit e arsimit profesional që kanë mbaruar vitin shkollor pararendës me të gjitha notat 10 (dhjeta).

2.3 Jashtë kriterit ekonomik:

a) Nxënës që kanë përfitur statusin e jetimit;

b) Nxënës që kanë humbur kujdestarinë prindërore, me vendim gjykate të formës së prerë;

c) Nxënës që gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik;

ç) Nxënës që gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë;

d) Nxënës fëmijë të personave që gëzojnë statusin e invalidit e që përfitojnë pension invaliditeti dhe nuk kanë të ardhura të tjera;

dh) Nxënës të komunitetit rom dhe egjiptian që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional;

e) Nxënës që janë identifikuar dhe trajtuar si viktima të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror;

ë) Nxënës, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.

Në fillim të çdo viti shkollor, por jo më vonë se data 31 dhjetor 2017, për këto kategori nxënësish, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ Shtetëror si dhe institucionet e përkujdesit social rezidencial publik duhet të dërgojnë, në njësitë bazë të qeverisjes vendore përkatëse ku ndjekin

studimet, listën e nxënësve përfitues, sipas pikës 2.3, të këtij vendimi.

2.4 Sipas degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm, nxënësit që ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional:

a) Në drejtimet mësimore: bujqësi, veterinari, pyje, ndërtim, peshkim, detari, gjeologji-miniera dhe shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe gazit.

b) Me vendbanim të përhershëm në zonat verilindore dhe juglindore të vendit: Dibër, Bulqizë, Mat, Kukës, Has, Tropojë, Pukë, Mirditë, Malësi e Madhe, Librazhd, Gramsh, Kolonjë, Përmet, Skrapar dhe Tepelenë.

3. Nxënësit e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të saj, kur:

a) janë ndarë nga trangu familjar;

b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;

c) shpallen ngelës apo përsëritës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese.

4. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në konsultim me institucionet arsimore, hartojnë planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe arsimit profesional, që ndjekin vitin e parë akademik 2017-2018 dhe ua dërgojnë njësisive bazë të qeverisjes vendore, jo më vonë se data 31 dhjetor 2017.

4.1 Drejtorët e shkollave profesionale, për nxënësit që regjistrohen dhe ndjekin studimet me kohë të plotë në vitin e parë shkollor 2017-2018, sipas pikës 2.4, të këtij vendimi, u dërgojnë informacion njësisive bazë të qeverisjes vendore, jo më vonë se data 20 dhjetor 2017.

5. Njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar për to, me vendim të këshillit bashkiak, miratojnë dhënien e bursave, sipas kritereve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4, të këtij vendimi, duke u dhënë përparësi nxënësve nga shtresat, kategoritë sociale në nevojë, për trajtimin me bursë të plotë. Për kushte ekonomike të barabarta në trajtimin me bursë, prioritet kanë nxënëset vajza. Njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, në pamundësi trajtimi me bursë të plotë, brenda planit të miratuar, mund të trajtojnë/miratojnë për nxënësit dhe gjysmë burse.

5.1 Nxënësit e shkollave profesionale që ndjekin vitin e dytë në drejtimet mësimore: bujqësi,



veterinari, pyje, ndërtim, peshkim, detari, gjeologji-miniera dhe shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe gazit, që kanë përfituar bursë në vitin e parë 2016-2017 dhe që nuk rezultojnë mbetës, përfitojnë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit.

5.2 Bursat e nxënësve për vitin e parë shqyrtohen dhe miratohen nga këshilli bashkiak, sipas vendbanimit të përhershëm të prindit/nxënësit, përfitues të bursës/kuotës ushqimore.

5.3 Bursat e nxënësve për vitin e dytë e lart rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit, nga këshilli bashkiak, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të shkollave profesionale apo konvikteve ku janë vendosur nxënësit, përfitues të bursës/kuotës ushqimore.

5.4 Njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, brenda numrit të përgjithshëm të bursave të dhëna për vitin akademik 2017-2018, mbështetur në numrin e nxënësve të regjistruar, vendosin për dhënien e bursave sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të shkollave profesionale dhe konvikteve në të cilat janë vendosur nxënësit.

6. Njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, detyrimisht duhet t'u dërgojnë zyrtarisht, jo më vonë se data 31 mars 2018, drejtorive të shkollave profesionale për arsimin profesional dhe drejtorive rajonale arsimore/zyrave arsimore, vendimet për dhënien e bursave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të raportojnë, zyrtarisht, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, çdo tre muaj, për fondet buxhetore të shpenzuara dhe numrin e nxënësve që trajtohen me kuota financiare të ushqimit në konvikte e bursa.

7. Të gjithë nxënësit/prindërit dhe drejtoritë e shkollave profesionale paraqesin/dërgojnë, zyrtarisht, në njësitë e qeverisjes vendore, kërkesat për miratimin e bursës, për nxënësit që përfitojnë bursë, sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4, të këtij vendimi.

Nxënësit që kanë përfituar bursë vitin e parë, me vendim të këshillit bashkiak, ku ata kanë vendbanimin e përhershëm dhe nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës e përfitojnë bursën deri në përfundim të viteve të shkollimit.

8. Gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës mësimore, nxënësit që kanë përfituar bursë nga njësia bazë e qeverisjes vendore, e përfitojnë atë

edhe gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës profesionale. Bursa jepet në formën e kuotës ushqimore ose kuotës financiare drejtpërdrejt në llogarinë bankare të nxënësit/prindit, të çelur pranë bankave të nivelit të dytë.

8.1 Për nxënësit që kanë përfituar bursë për vitin shkollor 2017-2018, drejtorët e shkollave profesionale, si dhe të shkollave të tjera të arsimit parauniversitar, dërgojnë zyrtarisht në datën 5 të çdo muaji, pranë njërive bazë të vetëqeverisjes vendore, informacion të detajuar për frekuentimin e shkollës/praktikës profesionale nga nxënësit që përfitojnë bursë.

9. Nxënësit që kanë përfituar statusin ligjor të jetimit, nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë, përfitojnë çdo vit, falas, veshmbathje, libra dhe fletore, sipas pasqyrës nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë përjashtohen nga detyrimet e tarifave të shërbimeve të ndryshme që ofrojnë institucionet shtetërore.

9.1 Nxënësve që kanë përfituar statusin ligjor të jetimit, të invalidit paraplegjik, tetraplegjik, statusin ligjor të personave që nuk shikojnë, të personave që nuk dëgjojnë, u sigurohen falas akomodimi/fjetja, shërbimi shëndetësor, shërbimi dentar dhe medikamentet, pas paraqitjes së librezës, të kartës shëndetësore, si dhe të epikrizës, nga qendra spitalore e rrethit.

9.2 Nxënësit jetimë që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit parauniversitar, trajtohen me pagesë suplementare edhe për periudhën e pushimeve verore, nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale.

9.3 Nxënësit e komunitetit rom dhe egjiptian që vazhdojnë studimet në shkollat e mesme profesionale, përfitojnë, falas, veshmbathje, libra dhe fletore, sipas pasqyrës nr. 4.

9.4 Fëmijët/nxënësit dhe mësuesit e institucioneve të arsimit special, me nevoja të veçanta psikosociale, pa konvikt, trajtohen me fonde të buxhetit të shtetit me një kuotë ushqimore (drekë), me vlerë deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë në ditë, si dhe libra e fletore, sipas pasqyrës nr. 4.

10. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për nxënësit administrohen nga njësitë e vetëqeverisjes



vendore, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve ku janë vendosur nxënësit konviktorë. Masa mujore e bursës u jepet nxënësve në formën e kuotës ushqimore në konvikte.

11. Nxënësve që përfitojnë bursë, të cilët nuk janë akomoduar në konvikte, për mungesë të akomodimit në konvikte, nxënësve që përfitojnë bursë sipas rezultateve të arritura, nxënësve që përfitojnë bursë jashtë kriterit ekonomik, si dhe nxënësve që ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional në degët parësore të zhvillimit ekonomik të vendit, të cilët nuk janë akomoduar në konvikte, masa e miratuar e bursës mujore u paguhet nga njësia e vetëqeverisjes vendore çdo muaj pranë bankave të nivelit të dytë, në llogarinë bankare të nxënësve/prindërve.

12. Njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore realizojnë pagesën e bursës për nxënësit përfitues, vetëm pasi drejtorët e shkollave profesionale konfirmojnë, zyrtarisht, brenda datës 5 të çdo muaji, pranë njësive të qeverisjes vendore, informacionin për ndjekjen/frekuentimin e shkollës për nxënësit që përfitojnë bursë.

13. Nxënësve që nuk frekuentojnë mësimin apo nuk ndjekin praktikën profesionale pa arsye ligjore apo shëndetësore u ndërpritet menjëherë bursa.

14. Masa e bursës për nxënësit jepet sipas pasqyrës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi, ndërsa kuota financiare ushqimore ditore jepet sipas pasqyrës nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

15. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për hyrjet e reja në vitin e parë, në sistemin arsimor publik që ndjekin shkollat profesionale, për të gjitha kategoritë e parashikuara në pikën 2, të këtij

vendimi, për vitin e ri shkollor 2017-2018, të japë 200 (dy mijë e njëqind) bursa.

16. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për të gjitha kategoritë e nxënësve që ndjekin arsimin parauniversitar, të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, pa përfshirë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale, për vitin e ri shkollor 2017-2018, të japë 800 (tetëqind) bursa.

17. Efektet financiare, të vitit akademik 2017-2018, të përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për vitin 2017 dhe 2018.

18. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave nga njësitë bazë të qeverisjes vendore, për të gjitha kategoritë e shkollave, është data 31 mars 2018. Vendimet e këshillave të njësive të vetëqeverisjes vendore të miratuara jashtë këtij afati janë të pavlefshme.

19. Vendimet e njësive bazë të qeverisjes vendore bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit për nxënësit, komunitetin, median dhe institucionet e tjera vendore apo qendrore.

20. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore, njësitë arsimore vendore (DAR/ZA), si dhe shkollat e arsimit të mesëm profesional për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



**Pasqyra nr. 1: KUSHTET EKONOMIKE TË NXËNËSIT PËR DHËNIEN E BURSËS
(VITI MËSIMOR 2017 - 2018)**

Nr.	Përbërja familjare Për qytetin	Përfitojnë bursa	Përfitojnë gjysmëbursa	Me pagesë
		Me të ardhura mujore lekë/frymë	Me të ardhura mujore lekë/frymë	Me të ardhura mujore lekë/frymë
1	Për familjet me 2 persona	Deri 3,200	3,200 - 4,600	Mbi 4,600
2	Për familjet me 3 persona	Deri 3,100	3,100 - 4,500	Mbi 4,500
3	Për familjet me 4 persona	Deri 3,000	3,000 - 4,400	Mbi 4,400
4	Për familjet me 5 persona	Deri 2,900	2,900 - 4,300	Mbi 4,300
5	Për familjet me 6 persona	Deri 2,800	2,800 - 4,200	Mbi 4,200
6	Për familjet me 7 persona	Deri 2,700	2,700 - 4,100	Mbi 4,100
7	Për familjet me 8 persona	Deri 2,600	2,600 - 4,000	Mbi 4,000

Pasqyra nr. 2: MASA E BURSËS PËR NXËNËSIT (VITI MËSIMOR 2017- 2018) në lekë

Nr.	Kategoritë e bursave sipas shkollave	Kuotat e bursës mujore në lekë			Financimi	
		Lekë për kuotë ushqimi	Shpenzime vetjake	Totali i kuotës	Financimi nga nxënësi/pridër	Financimi nga shteti
1	Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme					
	a) Bursa	6,455	200	6,655	0	6,655
	b) Gjysmëbursa	6,455	200	6,655	3,327.5	3,327.5
	c) Me pagesë	6,455	200	6,655	6,655	0
2	Shkolla e Mjeshtërisë Sportive e Arsimit Special					
	a) Bursa	7,017	200	7,217	0	7,217
	b) Gjysmëbursa	7,017	200	7,217	3,608.5	3,608.5
	c) Me pagesë	7,017	200	7,217	7,217	
3	Për nxënësit jetimë	7,017	200	7,217	0	7,217

**Pasqyra nr. 3: KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E NXËNËSVE
(VITI MËSIMOR 2017-2018)**

Nr.	EMËRTIMI	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar në lekë	Vlera ditore në lekë
1	Bukë	gram	350-400	977	100	35
2	Makarona	gram	30	107	120	3.6
3	Oriz	gram	30	109	150	4.5
4	Sheqer	gram	40	157	100	4
5	Fasule	gram	30	93	200	6
6	Perime	gram	130	27	100	13
7	Fruta	gram	100	42	100	10
8	Vaj	gram	30	270	180	5.4
9	Gjalpë	gram	20	152	650	13
10	Mish	gram	70-80	115	750	52.5
11	Djathë	gram	25	40	600	15
12	Reçel	gram	20	93	250	5
13	Vezë	kokërr	1	42	12.5	12.5
14	Qumësht	gram	200	98	80	16
15	Patate	gram	200	170	40	8
16	Nënprodukte mishi	gram	30	100	400	12
	Kuota ditore			2712		215.5

Shënim. Është e domosdoshme që nxënësi të marrë kuotën ditore në lekë dhe në kalori, ndërsa gramaturat dhe lloji i ushqimit mund të ndryshojnë sipas menyve të ndryshme, sipas çmimeve që ofrohen nga konkurrenca e në procesin e prokurimeve publike dhe ndikimit të faktorëve të tjerë (gramaturat e normës ditore në pasqyrë janë përdorur për efekt planifikimi).

Pasqyra nr. 4: KUOTAT FINANCIARE TË VESHMBATHJES (VITI MËSIMOR 2017-2018)

Nr.	Emërtimi	Kuota financiare në lekë e veshmbathjes për një vit kalendarik
1	Për fëmijët e arsimit special	7,000 (shtatë mijë) lekë
2	Për nxënësit romë dhe egjiptianë	7,000 (shtatë mijë) lekë
3	Për jetimët	10,000 (dhjetë mijë) lekë

**VENDIM****Nr. 754, datë 13.12.2017**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 408, DATË 8.5.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DËMSPËRBLIMIN PËR KAFSHËT E ELIMINUARA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 49, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 408, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Kudo në vendim, emërtimi “Drejtoria e Bujqësisë (DB)” zëvendësohet me “struktura përgjegjëse për veterinarinë në institucionin përkatës”.

2. Pika 8 riformulohet, me këtë përmbajtje:

“8. Procedura për dhënien e dëmshpërblimit për kafshët e eliminuara dhe të groposura, të cilat përmbushin kriteret e pikave 2 e 3, fillon brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga eliminimi dhe groposja e kafshës. Struktura përgjegjëse për veterinarinë, në institucionin përkatës, përgatit dosjen me kopjet e këtij dokumentacioni:

a) Pasaportën e kafshës që eliminohet dhe matricullin individual të saj;

b) Procesverbalin e eliminimit dhe të groposjes, në përputhje me pikën 3, të këtij vendimi;

c) Sipas rastit, dokumentet veterinarë për zbatimin e masave sanitaro-veterinare në fermë, të urdhëruara nga shërbimi veterinar, në bazë të të cilave është vendosur eliminimi dhe groposja e kafshës;

ç) Dokumentin që provon shitjen e produktit dhe çmimin, në rastet sipas pikës 13, i cili paraqitet nga pronari i kafshës.”

3. Në pikën 9, fjalët “... pas marrjes së kërkesës dhe të dokumentacionit të kërkuar nga pronari i kafshës...”, hiqen.

4. Në pikën 11, fjalët “...kërkesës e të...” dhe fjalët “...përgatitet nga Drejtoria e Shërbimit Veterinar në ministri dhe...”, hiqen.

5. Në pikën 17, fjalët “... Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave...” zëvendësohen me fjalët “...Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 755, datë 13.12.2017**

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 712, DATË 13.7.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT PUBLIK PËR TË DREJTËN E PESHKIMIT NË UJËRAT E BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 52, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 712, datë 13.7.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “c”, e pikës 4, shfuqizohet.

2. Pikat 9 e 10 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“9. Numri i lejeve të peshkimit në zonat e bashkëmenaxhimit përcaktohet në planin e bashkëmenaxhimit. Ministri përgjegjës, pas konsultimit paraprak me institucionet shkencore të specializuara të fushës, përcakton numrin e lejeve dhe llojet e caktuara të peshkimit.

10. Në kategoritë ujore ku nuk funksionojnë OMP-të, sipas pikës 7, të këtij vendimi, subjektet e interesuara për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit paraqesin në ministri një planbiznes të plotë për zhvillimin e veprimtarisë së synuar, duke përfshirë të dhëna personale të subjektit, si: NIPT-i, ID-ja, numri i kontaktit, si dhe të dhëna për nivelin e investimit e të punësimit, duke konsideruar statusin mjedisor të zonës.”

3. Pas pikës 10 shtohet pika 10/1, me këtë përmbajtje:



“10/1. Subjektet e interesuara, që dëshirojnë të ushtrojnë veprimtarinë e peshkimit në ujërat e brendshme, duhet të pajisen me leje peshkimi për ujërat e brendshme, e cila përfshihet në nënkategorinë “të gjitha përdorimet e tjera (peshkim në ujërat e brendshme, peshkim nga organizatat e bashkëmenaxhimit (OMP) dhe dhënien në administrim të lagunave dhe zonave të tjera ujore limitrofe)”, me kodin III.5.A.2.”

4. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Dokumentacioni i përcaktuar në pikën 10, të këtij vendimi, vlen për të gjitha subjektet e interesuara që paraqiten për konkurrim, sipas kategorive ujore të shpallura dhe llojit të aktivitetit, si më poshtë vijon:

- Për lagunat bregdetare, jo me dajlan;
- Për lumenjtë, bilance dhe stavnikë;
- Për peshkimin artizanal, me instalim stavniku në laguna dhe bregdet;
- Për lagunat bregdetare, me instalim dajlani;
- Për ujëmbledhësit e bujqësisë.”

5. Pas pikës 11 shtohet pika 11/1, me këtë përmbajtje:

“11/1. Për ujëmbledhësit e bujqësisë, pas shpalljes së fituesit në procedurën e konkurimit publik për të drejtën e peshkimit në këta ujëmbledhës, subjekti fitues lidh një aktmarrëveshje me bashkinë/drejtorinë e ujitjes dhe të kullimit, të cilat janë organet që administrojnë ujëmbledhësin, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.”

6. Pas pikës 12 shtohet pika 12/1, me këtë përmbajtje:

“12/1. Për ujëmbledhësit e bujqësisë, për të cilët nuk ka kërkesa për zhvillim aktiviteti, ministria njofton bashkinë/drejtorinë e ujitjes dhe të kullimit për shpalljen e konkurimit publik për ujëmbledhësin përkatës. Në rastin kur institucioni që administron këtë ujëmbledhës nuk përgjigjet brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve për këtë njoftim, ministria shpall konkurrimin.”

7. Pika 21 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“21. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1

AKTMARRËVESHJE PËR PËRDORIMIN E UJËMBLEDHËSIT PËR AKTIVITET PESHKIMI

E lidhur më datë ___/___/____, midis:
Bashkisë/Drejtorisë së Ujitjes dhe të Kullimit
“....., përfaqësuar nga
me funksion
dhe

Subjektit “.....”, me NIPT
.....përfaqësuar nga:
me adresë.....

Neni 1

Qëllimi

Ruajtja e sigurisë së digës së ujëmbledhësit në këtë aktmarrëveshje dhe garantimi i zhvillimit të aktivitetit të peshkimit për kohën e përcaktuar në kontratën me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit.

Neni 2

Baza ligjore

Ligji nr. 24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, ligji nr. 8681, datë 2.11.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave” dhe vendimi nr. 147, datë 18.3.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së sigurisë së digave dhe dambave”, pika 2, e nenit 52, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, dhe vendimi nr. 1108, datë 30.12.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të bashkitë të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”.

Neni 3

Kushtet e marrëveshjes

Të përgjithshme

1. Administruesi i ujëmbledhësit dhe subjekti që ushtron aktivitetin e peshkimit në ujëmbledhës, gjatë shfrytëzimit të tij, janë të detyruar të respektojnë kushtëzimet dhe duhet të udhëhiqen nga parimet, si më poshtë:

- Së pari, të garantojnë sigurinë e digës së ujëmbledhësit;



- Së dyti, të garantojnë sasinë e nevojshme të ujit për ujitje gjatë gjithë sezonit të ujitjes;

- Së treti, të garantojnë zhvillimin normal të aktivitetit të peshkimit.

Për administruesin e ujëmbledhësit

1. Administruesi i ujëmbledhësit përcakton grafikun e parashikimit të mbajtjes së nivelit të ujit në ujëmbledhës për një periudhë 1-vjeçare, bazuar në:

- a) projektin e shfrytëzimit të ujëmbledhësit;
- b) gjendjen e sigurisë së digës dhe nënobjekteve të saj, shkarkuesin katastrofik dhe ujëlëshuesit;
- c) përdorimin e ujit në periudha të ndryshme të vitit;
- ç) pllotave të mundshme.

2. Administruesi i ujëmbledhësit i vë në dispozicion subjektit që ushtron aktivitet peshkimi, grafikun e parashikimit të mbajtjes së nivelit të ujit në ujëmbledhës për kushte normale shfrytëzimi sipas përcaktimit në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Administruesi i ujëmbledhësit në raste të kushteve klimaterike, që shmangen nga mesataret shumëvjeçare (reshje mbi normalen apo thatësi e tejzgatur), në interes të ruajtjes së sigurisë së digës dhe sigurimit të ujitjes për ujitje, ka të drejtë të ndryshojë grafikun e parashikimit të niveleve të ujit në ujëmbledhës, duke njoftuar sa më shpejt subjektin e peshkimit për ndryshimet e mundshme të nivelit të ujit në ujëmbledhës, për të minimizuar dëmet e mundshme në aktivitetin e peshkimit.

4. Administruesi i ujëmbledhësit në rastet e planifikuara të ndërhyrjeve rehabilituese/riparuese në digë apo nënobjektet e saj, shkarkues katastrofik/ujëlëshues, duhet të njoftojë subjektin, që ushtron aktivitet peshkimi për nivelet e ujit, që do të mbahen në ujëmbledhës gjatë periudhës së realizimit të punimeve, për t'i mundësuar subjektit që ushtron aktivitet peshkimi, programimin e zhvillimit të aktivitetit të peshkimit në përshtatje me nivelet e ujit gjatë periudhës së rehabilitimit/mirëmbajtjes së digës.

5. Administruesi i ujëmbledhësit, në rastet e forcave madhore kur cenohet siguria e digës nga veprime të paparashikuara (kushte jonormale klimaterike, pllota, shkarje dhe cedime etj.) apo në rastet kur kërkohet të kontrollohet për arsye sigurie bjefi i poshtëm i digës nga brenda (për arsye emergjente), ka të drejtë të ulë menjëherë nivelin e ujit në ujëmbledhës në nivele të tilla, që garantojnë sigurinë e digës apo realizimin e kontrolleve të

domosdoshme. Në këtë rast, administruesi njofton menjëherë subjektin që ushtron aktivitet peshkimi dhe nuk mban përgjegjësi për dëmtimet që mund t'i vijnë aktivitetit që ushtron subjekti nga ulja e paplanifikuar e nivelit të ujit.

Për subjektin

1. Subjekti që ushtron aktivitet peshkimi, nuk duhet të cenojë sigurinë e digës nëpërmjet ndërhyrjeve me ndërtime, rehabilitime, modifikime në strukturat ekzistuese të ujëmbledhësit (trupin e digës, ujëlëshues, shkarkues katastrofik apo brenda kupës së ujëmbledhësit).

2. Subjekti që ushtron aktivitet peshkimi, nuk duhet të cenojë funksionimin normal të strukturave që shërbejnë për mbajtjen nën kontroll të nivelit të ujit në ujëmbledhës dhe shkarkimin e kontrolluar të ujit prej tij (ujëlëshues dhe shkarkues katastrofik), nëpërmjet dëmtimit të tyre, bllokimit, zvogëlimit të kapacitetit shkarkues etj.

3. Subjekti që ushtron aktivitet peshkimi në ujëmbledhës duhet të përdorë mjete dhe metoda të ligjshme në procesin e rritjes e të zënies së peshkut, pa shkaktuar dëmtime fizike të strukturave ekzistuese (trupit të digës, ujëlëshuesit dhe shkarkuesit katastrofik) dhe pa dëmtuar cilësinë e ujit.

4. Subjektin, që ushtron aktivitet peshkimi në ujëmbledhës, i ndalohet në mënyrë kategorike përdorimi i lëndëve eksplozive.

5. Subjekti që ushtron aktivitet peshkimi për qëllime të përmbushjes së aktivitetit të tij, nuk duhet të krijojë infrastrukturë ndihmëse në trupin e digës dhe kupën e ujëmbledhësit, si rrugëkalim për automjete, përdorimin e digës apo strukturave të tjera (ujëlëshues dhe shkarkues katastrofik) si vendparkimi apo vend për ngarkimin dhe shkarkimin e mjeteve lundruese.

6. Subjekti, që ushtron aktivitet peshkimi, nuk duhet të lëvizë me mjet transporti në kurorën e digës.

Neni 4

6. Ruajtja e sigurisë së digës të ujëmbledhësit të gjatë përdorimit të këtij ujëmbledhësi të mbikëqyret nga subjekti që është pajisur me kontratë për aktivitet peshkimi sipas legjislacionit në fuqi për peshkimin.



Neni 5
Vlefshmëria

Kjo marrëveshje merr vlerë vetëm e shoqëruar me kontratën e lidhur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me subjektin fitues në konkurrimin publik të shpallur nga ana e saj.

Afati i kësaj marrëveshjeje është i njëjtë me afatin e kontratës për ushtrim aktiviteti peshkimi të subjektit me NIPT.....në ujëmbledhësin e

Neni 6

Çdo ndërhyrje e paligjshme në strukturat ekzistuese të ujëmbledhësit, kur nuk përbën veprë penale, ndëshkohet sipas nenit 46, të ligjit nr. 24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”.

Neni 7

Kjo marrëveshje nënshkruhet brenda 60 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës së ushtrimit të aktivitetit të peshkimit dhe përpilohet në 3 (tri) kopje, ku nga një kopje mbahet nga palët dhe kopja e tretë depozitohet (depozitohet me postë) në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për t'u administruar në dosjen e subjektit fitues.

Neni 8

Për të gjitha çështjet e parashikuara në këtë marrëveshje vlejné normat e legjislacionit shqiptar.

Neni 9

1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje, do të zgjidhen me mirëkuptim midis palëve, në rast të kundërt:

a) kur mosmarrëveshjet kanë të bëjnë me veprime të përsëritshme nga ana e subjektit të peshkimit, që cenojné sigurinë e digës dhe nënobjekteve të saj dhe veprime që cenojné realizimin e ujitjes, marrëveshja ndërpritet në mënyrë të njëanshme nga bashkia/drejtoria e ujitjes dhe të kullimit, e cila njofton Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si autoriteti kontraktues përkatës për fillimin e procedurave të zgjidhjes së kontratës.

b) Kur mosmarrëveshjet kanë të bëjnë me uljen e nivelit të ujit pa lajmëruar subjektin e peshkimit sipas përcaktimeve të kësaj marrëveshjeje, duke shkaktuar dëmtime në aktivitetin e peshkimit, administruesi të zhdëmtojë subjektin e peshkimit, pas vlerësimit të dëmit nga vlerësues të pavarur.

Neni 10

1. Të gjitha pikat e kësaj marrëveshjeje janë pranuar nga palët dhe nuk mund të ndryshohen ose modifikohen në asnjë mënyrë tjetër, përveçse me një dokument të shkruar dhe të nënshkruar nga palët nënshkruese të marrëveshjes.

2. Çdo ndryshim i bërë sipas pikës 1 të këtij neni dërgohet edhe në Ministri.

Neni 11

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet e tjera midis palëve në lidhje me objektin e kësaj marrëveshjeje do të bëhen me shkrim dhe do të dërgohen me faks ose me postë.

Njoftimet do të quhen të marra nga data kur faksi është transmetuar ose kur objekti postar është dorëzuar në shërbimin postar, duke shënuar adresën përkatëse për secilën palë.

Adresat e palëve do të jenë, si më poshtë:

Për Bashkinë/Drejtorinë e Ujitjes dhe të Kullimit_____

Adresa postare _____

Tel: +355 _____

E-mail: _____

Për subjektin_____

Adresa postare: _____

Tel: +355 _____

E-mail: _____

Neni 12

Marrëveshja nënshkruhet më _____

PËR BASHKINË/DREJTORINË E UJITJES
DHE TË KULLIMIT
(.....)

PËR SUBJEKTIN _____
(.....)

Formati 61x86/8

Shtypshkronja KRISTALINA
Tiranë, 2017

Çmimi 168 lekë